



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian
Mbledhja nr. 87

Prishtinë: Dt. 07.06.2024, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Fridon Lala, Agon Batusha, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Blerta Deliu-Kodra dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Alban Bajrami, Elmi Reçica.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha, Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 23.05.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-275 për rrugët, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Fjolla Ujkani propozoi që në rend dite të përfshihet edhe një pikë shtesë: *Projektligji nr. 08/L-289* për Komisionin e Pavarur të Mediave, me amendamentet e Komisionit funksional.

Rendi i ditës u miratua, i plotësuar.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 23.05.2024

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, tha se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë.

Lidhur me këtë projektligj, kemi edhe amendamentet e Komisioni funksional, ndërsa sa i përket përafrimit me legjislacion të BE-së, ky projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacion të BE-së.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni nuk kishte kuorum për vendimmarrje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, lidhur me këtë projektligj, tha se nuk është i rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e BE. Janë dhënë propozime dhe rekomandime nga institucionet e BE-ja, por që nuk janë marrë parasysh nga Komisioni funksional. Kam edhe një e-mail nga ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomáš Szunyog, për mospërfshirjen e propozimeve dhe rekomandimeve të BE-së.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni nuk kishte kuorum për vendimmarrje.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-275 për rrugët, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja, tha se ky projektligj ka për qëllim të rregullojë pozitën juridike, mënyrën e përdorimit të rrugëve publike të kategorizuara dhe të pakategorizuara, planifikimin, ndërtimin, financimin, kategorizimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen, masat për mbrojtjen e rrugëve, trafikut që zhvillohet në to dhe themelimin e Agjencisë së Rrugëve të Kosovës.

Lidhur me këtë projektligj, kemi edhe amendamentet e Komisionit funksional, ndërsa sa i përket përafritit me legjislacion të BE-së, ky projektligj nuk është i rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni edhe për këtë Projektligj nuk kishte kuorum për vendimmarrje.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja, tha se qëllimi i këtij ligji është bashkërendimi dhe bashkëpunimi institucional në fushën e sigurisë kombëtare, përmes Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë projektligj, kemi edhe amendamentet e Komisionit funksional, ndërsa sa i përket përafritit me legjislacion të BE-së, ky projektligj nuk është i rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni edhe për këtë Projektligj nuk kishte kuorum për vendimmarrje.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja, tha se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zyrtarët publikë, duke përfshirë zbatimin e urdhrin të dhënë në aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë projektligj, kemi edhe dy amendamente të Komisionit funksional, ndërsa sa i përket përafritit me legjislacion të BE-së, ky projektligj nuk është i rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni nuk kishte kuorum për vendimmarrje.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, tha se ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Mediave për promovimin e zhvillimit të një tregu të shërbimeve mediale audiovizuale, që u shërben të gjithë qytetarëve. Lidhur me këtë projektligj, kemi edhe amendamentet e Komisionit funksional dhe është konstatuar se projektligji, së bashku me amendamente, është pjesërisht në përputhje me legjislacion të BE-së.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni nuk kishte kuorum për vendimmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:25.

*E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.*

Kryetare e Komisionit,

Rrezarta Krasniqi